



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 904 / 2 Prot.

Tiranë, më 16/6 / 2017

REKOMANDIM

Nr. 20 datë 16/6 / 2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.154, datë 08.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr. 154, datë 08.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, ofron këshillim telefonik dhe këshillim ballë për ballë për gra e vajza, ofron ndihmë për viktimat e dhunës në familje duke i referuar në shërbime të tjera si: strehëza, asistencë ligjore falas, kurse trajnimi për gjetjen e punës, me qëllim integrimin e grave që janë viktimat të dhunës.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për subjektet e dhënave "punëmarrës" e "përfituese". Përpunimi i të dhënave kryesisht realizohet në mënyrë manuale (nëpërmjet formatit letër) si dhe në mënyrë elektronike.

Në kontrollin e ushtruar pranë këtij kontrolluesi, konstatohet se përpunohen të dhëna bazike, por dhe të dhëna sensitive të grave dhe vajzave të dhunuara fizikisht apo psikologjikisht.

Parimi i konfidencialitetit, është një nga parimet bazë të aktivitetit të kontrolluesit, por ky parim mbetet i pa konkretizuar në akte të brendshme të kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk e ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.
Konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të ligjit - "1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të

parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konstatimi i pikës së dytë, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, – *“1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.*

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.

3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas standartit të parashikuar në Vendimin Nr.6 të Komisionerit datë 05.08.2013.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit - *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.*

4. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar të tij “Politikat e Privatësisë”. Informacioni i publikuar në “Politikat e Privatësisë”, ka për qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi i pikës së katërt, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, - *“1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”.*

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të realizojë detyrimin për Njoftim, pranë Zyrës së Komisionerit, e në vazhdimësi përditësimin e tij.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të hartojë dhe përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”.
3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën “Politikat e Privatësisë”.
4. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të aplikojë “Deklaratën e Konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët aksesojnë të dhëna personale.
5. Kontrolluesi *Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza* Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikën 1 brenda tre ditëve, ndërsa për pikat 2, 3 dhe 4 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 16/06/2017

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI